



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 91, datë 26.07.2021

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR.123, DATË 24.12.2020 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2021, SI DHE PROJEKTBUXHETIN AFATMESEM TË BASHKISË DURRËS PËR VITET 2021-2023”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 137/2020, ”Për buxhetin e vitit 2021”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të buxhetit”, VKB-së nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projektbuxhetin afat mesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”, si më poshtë vijon:

**Pakësohet:**

<b>Programi</b>	<b>Emërtimi projektit</b>	<b>Llog.</b>	<b>Fondi në lekë</b>
-----------------	---------------------------	--------------	----------------------

<b>buxhetor</b>		<b>Ekonomike</b>	
04520	Studim projektimi rruga Gjellbërimi - Azem Hajdari	230	4,000,000
08220	Realizim vepra arti në rotandat e qytetit	231	5,000,000
	<b>TOTALI</b>		<b>9,000,000</b>

Shtohet :

<b>Programi buxhetor</b>	<b>Emërtimi projektit</b>	<b>Llog. Ekonomike</b>	<b>Fondi në lekë</b>
08130	Studim projektim për rikonstruksionin e Pallatit të Sportit "Ramazan Njala"	230	9,000,000
	<b>TOTALI</b>		<b>9,000,000</b>

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 26.07.2021**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 549/prot.  
4

Durrës, më 30.07.2021

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓  
Durrës

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.91 datë 26.07.2021:

“Për miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

